

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “**SHPORTA E BEBES**”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **33681000-7 - Biberon, mburoja gjiri dhe artikuj të ngjashëm për bebe**

VLERA E FONDIT LIMIT: **24.994.998 (njëzet e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: *Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (2021, 2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".*

2.2.2 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 2 (dy) vitet e fundit financiare përkatësisht (2021, 2022) në një vlerë jo më të vogël se vlera e parashikuar e kontratës dhe konkretisht 24.994.998 (njëzet e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.*

"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet:

.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;". Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye,

vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. (Operatori ekonomik i kualifikuar në vend të parë duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe*

ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për*

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratë nga administratori i shoqërisë për produktet/ artikujt që ofrojnë për realizimin e kontrates duke përcaktuar në deklaratë llojin dhe specifikimet teknike për çdo produkt/ artikull të kërkuar referuar preventivisht.

Argumentimi: *Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të nenit 77 pika 1 “Për prokurimin publik” ku parashikohet se: “Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.*

Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përpunueshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor (grupi i punës), për këto produkte.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim të lëshuar nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar (ku të provohet/ dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit autorizohet të tregëtojnë artikujt/ produktet objekt prokurimi, i cili duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kontratës. *Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana jonë.*

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përvecse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky*

kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin mënyrën e prezantimit të “Shportës së bebes” me produktet/ artikujt që do përmbajë, shoqëruar me foto.

Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: *Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të bërë krahasueshmërinë e mallrave të ofruara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor.*

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit nga një mostër në ambjentet e AK (Drejtoria e prokurimeve), 1 (një) copë për artikujt/mallrat objekt prokurimi.

- Mostrat/ produktet objekt prokurimi duhet të paraqiten/ prezantohen të amablazhuara në formën e “Shportës së bebes” me produktet/ artikujt që do të përmbajë.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.

- Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në DST. *Mosparaqitja e mostrave dhe prezantimit të përcaktuar sa më sipër është kusht për skualifikim.*

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin/produktet e kërkuara si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi duke bërë krahasueshmërinë me mostrat e mallrave objekt prokurimi .*

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë nga administratori i shoqërisë se merr përsipër me anë të mjeteve të tij të bëjë furnizimin, transportin të “Shportës së bebes” me shpenzimet e tij në vendndodhjen e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, brenda një afati 1-ditor, sipas kërkesave të AK.

Për kryerjen e transportit, duhet të disponojë të paktën 2 mjete tip furgon te pajisur me dokumentacion si më poshtë:

Për të vërtetuar disponimin e këtyre mjeteve, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Në rastet kur mjetet janë në pronësi:

- *Certifikatë pronësie;*

- dokument që vërteton regjistrimin e mjetit- Leje Qarkullimi;
- siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit);
- çertifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS)
- taksa vjetore

Në rastet kur mjetet janë me qera:

- Kontratë Qeraje noteriale për gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi;
- *Certifikatë pronësie;*
- dokument që vërteton regjistrimin e mjetit- Leje Qarkullimi;
- siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit);
- çertifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS);
- taksa vjetore

Shënim: Kriteri 2.3.6 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5/ç, të nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Mjetet e mësipërme janë të domosdoshme pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim arritjen e bindjes në përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a. Deklaratë nga Administratori i shoqërisë se ka ambiente të përshtatshme magazinimi dhe se merr përsipër të magazinohet në ambientet e tij mallrat objekt prokurimi dhe do të lëvrojë mallrat sipas kërkesës së AK në vendndodhjen e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

b. Në përmbushje të këtij kriteri, Operatori ekonomik për magazinimin e mallrave objekt prokurimi në funksion të realizimit të kontratës, duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

b.1 Një ambient magazinimi të përshtatshëm jo më të vogël se 500 m², i cili duhet të jetë brenda territorit të Bashkisë së Tiranës. Për këtë, operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton pronësinë/ qiramarrjen si më poshtë:

b.1.1 Dokumentacion që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

b.1.2 Dokumentacion që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje (e vlefshme)

Argumentimi: Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Qëllimi i projektit është mbështetja e nënës së re me qëllim aftësimin për ruajtjen e mirëqenies fizike, emocionale dhe psikologjike dhe mësimin e shprehive për t'u kujdesur për të porsalindurin. Synimi i kësaj shporte është mbështetja në ditët e para të lindjes, me produktet e nevojshme dhe të domosdoshme për çdo nënë e cila ka sjellë në jetë të një bebe.

Përfitues të drejtpërdrejtë të Shporta e bebes”, e cila përmban një shportë produktesh të nevojshme për fëmijën e sapo ardhur në jetë, do të jenë të porsalindurit në martenitetin publik “Mbretëresha Geraldine” ose “Koço Glozheni” dhe shpërndarja e “Shportës së bebes” do të realizohet, bazuar në numrin e lindjeve të regjistruara nga punonjësit e gjendjes civile pranë këtyre institucioneve Shëndetësore/marteniteti publik “Mbretëresha Geraldine” ose “Koço Glozheni”, ku foshnjat kanë lindur. Bashkia Tiranë për çdo përfitues do të dhurojnë shportën e cila do të përfitohet nga prindi/prindërit nga dita e lindjes së fëmijës.

Referuar sasisë dhe përmasave të artikujve objekt prokurimi, AK Bashkia Tiranë nuk ka ambjente ruajtje dhe magazinimi të mjaftueshme por as të përshtatshme ku të mund të mbajë një sasi produktesh të një natyre sensitive dhe me afate skadence dhe ruajtje të tyre në temperatura apo kushte të përshtatshme. Për këtë arsye, AK ka kërkuar që kjo të mundësohet nga OE fitues i cili do të realizojë furnizimin e produkteve/ artikujve brenda afatit të kërkuar referuar afatit të ekzekutimit të kontratës së përcaktuar nga AK në DST dhe do të mbajë ato të magazinuar duke i lëvruar ato sipas kërkesave të AK sipas rastit sa herë që Autoriteti të ketë nevojë.

Natyra e procedurës së prokurimit kërkon që të gjitha shportat para marrjes në dorëzim nga strukturat e posaçme të AK Bashkia Tiranë, duhet të jenë konform mostrave të paraqitura pranë AK, specifikimeve teknike, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar nga Bashkia Tiranë, gjë e cila nënkupton se punonjësi/t e AK Bashkia Tiranë që janë ngarkuar për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të jenë prezent në momentin e marrjes në dorëzim dhe të konfirmojnë që ato plotësojnë kërkesat sipas specifikimeve teknike.

Malli do të quhet i marrë në dorëzim pasi të jetë kontrolluar për cilësinë dhe nëse është ose jo në përputhje me specifikimet teknike. Në rast se punonjësit si më sipër, do të konstatojnë se produkti/et nuk janë konform specifikimeve, apo nuk janë të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar nga Bashkia Tiranë, atëherë OE është i detyruar të kthejë mbrapsht mallin. Pra në këtë kontekst, OE i cili do të dispononte një ambjent magazinimi jashtë territorit të Tiranës, do e bënte të pamundur realizimin në kohë si pasojë e largësisë, kohës së nevojshme për të arritur në destinacion etj, të përfutimit të produkteve Shporta e bebes nga prindi/prindërit në ditën e lindjes së fëmijës.

Duke qenë se malli do të mbahet dhe ruhet në ambjetet e OE, punonjësi i ngarkuar për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, ka për detyrë të bëjë verifikime të herë pas herëshme pranë magazinës së OE për të verifikuar përshtatshmërinë e kushteve të ruajtjes së produkteve objekt prokurimi. Pra, ambjenti i magazinës duhet të jetë lehtësisht dhe njëkohësisht i aksesueshëm nga punonjësi që ndjek zbatimin e kontratës.

2.3.8 Për të garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për furnizimin që do të kryejnë, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e Cilësisë **ISO 9001- 2015** ose i përditësuar (e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën Iso).

Argumentimi: Kriteri për paraqitjen e **ISO 9001- 2015** u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në bazë të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se këto Çertifikata duhet të jenë lëshuar nga organizma çertifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur me aftësinë e tyre për të realizuar kontratën. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikimet e nevojshme të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për realizimin e objektit të kontratës.

Kërkesa për certifikim sipas standardeve ISO është në vetvete një garanci me teper për suksesin e projektit, në lidhje me cilësinë e produktit. Përbushja e standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron manaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë dhe mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga Operatori Ekonomik, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit, planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit/shërbimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të

ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

b. Operatori ekonomik fitues, para nënshkrimit kontratës duhet të dorëzojë:

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softwerike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimi i parametrave teknik, materialeve etj:

1. Shampo për bebe

Shampoja duhet të jetë në sasinë 500-750ml.

Shampoja duhet të pastrojë butësisht flokët dhe lëkurën e bebit, të ketë veti qetësuese për lëkurën. Të ruajë vlerat natyrale të Ph të lëkurës. Të jetë anitalergjike. Të shplahet lehtë dhe të mos irritojë sytë.

Të jetë i testuar dermatologjikisht.

Të mos përmbajë paraben, alkool dhe ngjyrues.

Të ketë përbërje ujë, substancë hidratuese dhe ushqyese për foshnjën.

Të përmbajë Aloe vera dhe/ose Kamomil ose vaj jojoba ose vaj bajamesh.

Të përmbajë certifikimin sipas standardeve SSH EN ISO 22716:2007 ose ekuivalente

2. Letër e lagur për bebe

Pako me letra të lagura të ketë jo më pak se 70 fije

Letër e lagur për pastrimin e pjesëve intime dhe jo intime të bebes.

Të ketë përmbajtje të lartë pambuku dhe uji.

Të mbajë të butë lëkurën e bebit dhe të mos e acarojë.

Letra e lagur nuk duhet të ketë parfum, pa sapun, pa paraben, pa alkool në përbërjen e tyre.

Letra e lagur duhet të jetë e testuar klinikisht.

Letra e lagur duhet të ruajë vlerat natyrale të Ph të lëkurës.

Të përmbajë Aloe vera dhe/ose Kamomil.

3. Krem hidratues për bebe me vitamina

Kremi hidratues të jetë në sasinë 150 ml – 200 ml.

Kremi hidratues të ketë efekt zbutës së lëkurës së bebes.

Të mos krijojë irritim të lëkurës dhe të jetë antialergjik i provuar klinikisht.

Të mos përmbajë paraben, alkool, parfum apo ngjyrues në përbërjen e tij.

Të ruajë vlerat natyrale të Ph të lëkurës.

Të sigurojë hidratim të thellë të lëkurës.

Të përmbajë Vitamine E dhe Vaj bajamesh ose vaj orizi ose Gjalp (shea).

Të përmbajë certifikimin sipas standardeve SSH EN ISO 22716:2007 ose ekuivalente

4. Vaj hidratues trupi për bebe

Vaji i trupit për bebe të jetë në sasinë 200 ml -250 ml.

Të ketë efekt zbutës dhe hidratues të lëkurës së bebes. Të sigurojë një hidratim të mirë pas dushit.

I përshtatshëm për të masazhuar lëkurën e bebes butësisht pas dushit ose para gjumit

Të mos përmbajë konservues dhe të përthithet lehtësisht nga poret e lëkurës së bebit.

Të mos krijojë asnjë lloj reaksioni apo irritimi të lëkurës.

Të jetë i përshtatshëm për trajtimin e koreve të kokës dhe ashpërsimit të lëkurës.

Të jetë i testuar dermatologjikisht.

Të përmbajë Vitaminë E dhe ekstrakt tërshëre ose vaj bajamesh ose kamomil, ose aloe vera.

Të përmbajë certifikimin sipas standardeve SSH EN ISO 22716:2007 ose ekuivalente

5. Pelena një përdorimshe për bebe masa 1

Pelena të jetë e masës 1.

Pako me pelena të ketë jo më pak se 27 fije

Materiali përbërës të jetë i butë dhe delikat. Në pjesët anësorë të jenë me elasticitet që të bëjnë veshjen e tyre të rehatshme në trupin e bebes. Pelena duhet puthitet mirë me trupin e foshnjës dhe duke i ofruar rehati në lëvizje.

Veshje e jashtme me mundësi ajrosje të lëkurës së bebes.

Të kenë material përthithës cilësor në mënyrë që të thithet sa më mirë lagëshitira e krijuar dhe të mbajë lëkurën e bebes të thatë dhe të pa irrituar.

Të jetë i testuar dermatologjikisht.

Të përmbajë certifikimin sipas standardeve SSH EN ISO 9073-14:2006 ose ekuivalente

6. Shishe qelqi me Biberon

Biberoni të jetë i përshtatshëm për ushqyerje të bebes së moshës 0- 6 muaj.

Materiali i trupit të biberonit të jetë 100 % qelq dhe i dozuar në ml (në sasinë 150 ml -250 ml)

Materiali i kokës të jetë silikon i butë mjeksor.

Të ketë një sistem ajrimi anti-kolik dhe të jetë projektuar posaçërisht për të imituar ushqyerjen natyrore me gji, duke ndihmuar në kalimin nga ushqyerja me gji në atë me shishe në mënyrë më të lehtë.

Materiali të jetë rezistent ndaj nxehtësisë në mënyrë që të streilizohet pa problem.

Duhet të jetë higjenik dhe i sigurt.

Të ketë formën e biberonit si koka e gjirit të nënës, duke bërë të mundur imitim në perfeksion për daljen e qumështit si nga gjiri i nënës.

Koka e biberonit duhet të jetë me kënd që të lejojë pozicionim perfekt të gojës si dhe frymëmarrjen gjatë ushqimit.

7. Biberon fallco

Biberon fallco i pajisur me një unazë, lehtësisht i përdorshëm.

I përshtatshëm për fëmijët e moshave mbi 0 muajsh (0 muaj +).

Biberoni të jetë i hollë dhe fleksibël për gojën e bebes

Materiali të jetë 100% silikon.

Të ketë material silikon edhe nga jashtë për të garantuar kontakt delikat edhe me fytyrën e fëmijës.

Të kënaqë nevojën natyrore të bebit për gjirin e nënës.

Të ketë formë ortodontike.

Të ndihmojë në zhvillimin korrekt të nofullave. Ndhmon në zhvillimin e qiellzës.

Të suportojë ekuilibrin e mirë thithje-frymëmarrje që foshnja mos të rrezikohet nga bllokimi.

Të përmbajë certifikimin sipas standardeve SSH EN 1400:2013+A2:2018 ose ekuivalente

8. Lodër pellush

Lodra pellush duhet të jetë e përshtatshme për moshën 0-3 muaj.

Materiali përbërës i lodrës të jetë i butë, antialergjik për fëmijën.

Të pastrohet lehtësisht.

Të përmbajë certifikimin OEKO-TEX, certifikatë cilësie.

9. Libër bebe

Libri të jetë një botim i përshtatur me informacione të vlefshme për kujdesin ndaj fëmijës në vitet e para të jetës së fëmijës. Të jetë me figura ilustruese për të qartësuar veprimet.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Përshkrimi dhe analiza sociale e projektit

Bashkia e Tiranës me qëllim ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave që i ngarkon legjislacioni në fuqi, për realizimin e shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë, me qëllim për të ndihmuar nënat e reja në ditët e para pas lindjes synon realizimin e projektit “Shporta e Bebes”.

Bashkia e Tiranës referuar programit e Kujdesit Social dhe të Edukimit, ka në fokus të saj edukimin dhe mirërritjen e fëmijëve brenda standardeve të miratuara si një nga objektivat strategjike prioritare. Fëmijët duket se janë kategoria më e ekspozuar ndaj rreziqeve për shkak të moshës, të pjekurisë fizike dhe intelektuale, prandaj ato kanë nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të veçantë nga familja, shoqëria dhe institucionet shtetërore. Në këtë kuadër kjo politikë në nivel vendor synon hartimin dhe aplikimin e projekteve që sigurojnë mbrojtje dhe kujdes të veçantë për fëmijët, në zbatim të standardeve kombëtare të miratuara dhe ato europiane, nëpërmjet fuqizimit dhe mbështetjes së vazhdueshme të gjithë familjeve të reja të Bashkisë Tiranë.

Gjithashtu, referuar nenit 24 të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar përcaktohet se Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Meqënëse për nënat e reja ardhja në jetë e të porsalindurit është një fazë tranzitore e cila, si dhe nisur nga fakti që kjo periudhë shoqërohet ndryshime fizike e psikologjike, plot me sfida dhe vështirësi në familje, vlerësojmë që prindërve të rinj të cilët kanë sjellë në jetë fëmijën, ti mundësohet edhe mbështetje materiale nëpërmjet ofrimit të një shporte me produktet kryesore imediate që nevojiten për një foshnje të porsalindur.

Kjo iniciativë ka në fokus të saj realizimin me sukses të objektivave dhe përgjegjësi që i ngarkon legjislativon në fuqi, njësi të qeverisjes vendore, e më konkretisht ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, në kuadër të kujdesit dhe mbrojtjes që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës, duke synuar zgjerimin e fushës së mbështetjes sociale edhe në kujdesin parësor ndaj fëmijeve të porsalindur.

Gjithashtu referuar ligjit nr. 7531, datë 11.12.1991 “Për ratifikimin e konventës për të drejtat e fëmijës”, shtetet palë angazhohen të respektojnë dhe t’i sigurojnë çdo fëmijë që përfshihet në juridiksionin e tyre mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke marrë të gjitha masat e mundshme në mënyra të ndryshme për të siguruar zhvillimin e tyre. Politikat e hartuara për përmbushjen e këtij qëllimi kanë në fokus interesin më të lartë të fëmijës.

Projekti “Shporta e bebes”, vjen si një risi në jetën sociale të komunitetit të Tiranës, duke synuar mbështetjen e nënës së re me qëllim aftësimin për ruajtjen e mirëqenies fizike, emocionale dhe psikologjike dhe mësimin e shprehive për t’u kujdesur për të porsalindurin. Synimi i kësaj shporte është mbështetja në ditët e para të lindjes, me produktet e nevojshme dhe të domosdoshme për çdo nënë e cila ka sjellë në jetë të një bebe.

Për sa më lart, me qëllim për të ndihmuar nënat e reja në ditët e para pas lindjes, Bashkia Tiranë miratoi projektin “Shporta e bebes”, e cila përmban një shportë produktesh të nevojshme për fëmijën e sapo ardhur në jetë.

Qëllimi i projektit është mbështetjen e nënës së re me qëllim aftësimin për ruajtjen e mirëqenies fizike, emocionale dhe psikologjike dhe mësimin e shprehive për t’u kujdesur për të porsalindurin. Synimi i kësaj shporte është mbështetja në ditët e para të lindjes, me produktet e nevojshme dhe të domosdoshme për çdo nënë e cila ka sjellë në jetë të një bebe.

Objektivat e projektit janë:

- Sigurimi i mbrojtjes së veçantë të fëmijës, duke synuar zgjerimin e fushës së mbështetjes sociale edhe në kujdesin parësor ndaj fëmijeve të porsalindur
- Sigurimi i kujdesit të nevojshëm për mirëqenien dhe zhvillimin e çdo fëmije në Bashkinë e Tiranës.

- Mbështetja e nënës së re me qëllim aftësimin për ruajtjen e mirëqenies fizike, emocionale dhe psikologjike dhe mësimin e shprehive për t' u kujdesur për të porsalindurin

Përfituesit e drejtpërdrejtë të këtij projekti do të jenë të porsalindurit në martentitetin publik “Mbretëresha Geraldine” ose “Koço Glozheni”, prindi/prindërit e të cilëve janë me vendbanimin të përhershëm në Tiranë.

Rezultatet e pritshme të këtij projekti janë:

- Aplikimi i skemave të reja për mbrojtje dhe kujdes të veçantë për fëmijët.
- Fuqizim dhe mbështetje e vazhdueshme të gjitha familjet e reja të Bashkisë Tiranë.
- Reduktimi i ankthit të nënës së re në ditët e para pas lindjes

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Baza materiale për një “Shportë bebe” me qëllim përmbushjen e objektivave të këtij projekti, përmban një shportë produktesh të nevojshme për fëmijën e sapo ardhur në jetë, si më poshtë:

1 Pako Pelena një përdorimshe masa 1

1 Shishe qelqi me biberon

1 Shampo për bebe

1 Letra të lagura për fëmijë

1 Krem për bebe me vitamina

1 Vaj hidratues trupi

1 Biberon fallco

1 Lodër pellushi

1 Një botim për kujdesin ndaj fëmijës në vitet e para të jetës.

Operatorët ekonomik ofertues duhet të përmbushin të gjitha specifikimet teknike për produktet përbërese të shportës së bebes.

Shpërndarja e “Shportës së bebes” do të realizohet, bazuar në numrin e lindjeve të regjistruara nga punonjësit e gjendjes civile pranë institucioneve shëndetësore ku foshnjat kanë lindur. Bashkia Tiranë për çdo përfitues që paraqitet për tërheqjen sipas kriterëve të mësipërme do të dhurojnë shportën.

Projekti “Shporta e bebes” e konceptuar si Shporta e bebes” do të përfitohet nga prindi/ prindërit nga dita e lindjes së fëmijës.

1. Malli do të merret në dorëzim në magazinën Operatorit Ekonomik Fitues.
2. Produktet objekt prokurimi për një “Shportë bebe”, do të jenë të ambalazhuar në një shportë kashte ose kuti/ “çantë” paketimi dekorative.
3. Procesi i shpërndarjes do të menaxhohet nga strukturat e Bashkisë Tiranë

Detajimi i procedurave operacionale të zbatimit të tij, me qëllim realizimin dhe zbatimin e projektit “Shporta e Bebes” si dhe përmbylljen me efikasitet të këtij projekti, do të përcaktohen në kontratën e lidhur ndërmjet Bashkisë së Tiranës dhe subjektit të shpallur fitues për realizimin e tij.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët e fushës, anëtar të njësisë së prokurimit. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 13.10.2023 ora 11:00

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Shporta e Bebes”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

- Dokumentat e tenderit.

NJËSIA E PROKURIMIT